



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 85762021
Data: 02.11.2021

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e nëntë -IX- për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 21.09.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetarë i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet e Financa), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim , Kulturë, Rini dhe Sport), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2023-2024.
3. Draft plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2022.
4. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson:- z.Sherif Lusnjani ka parashtruar kërkesë për ndërrim destinim të pronës por për shkak kohës nuk kemi pasur mundësi me përgatitur lëndën. Kërkoj që të hynë si pikë e rendit të punës dhe në momentin që do të përgatitet materiali do ta përcjellim për kuvend.

Kryesuesi thekson:- kërkesat për ndërrim destinim i kemi përcjell drejtë për mbledhje të kuvendit nuk është problem. A keni edhe ndonjë diskutim për rendin të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
- 2. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2023-2024.**
- 3. Draft plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2022.**
- 4. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022.**
- 5. Kërkesa e z.Sherif Lusnjani për ndërrim destinim të pronës.**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2023-2024.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- buxheti i përgjithshëm i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022 është në shumë prej 2,759,758 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2023 janë në shumë prej 2,903,855 € dhe për vitin 2024 janë në shumë prej 3,039,398 €. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2022 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje buxhetore: paga dhe shtesa 1,756,083€, mallra dhe shërbime 385,975 €, shpenzime komunale 67,700 €, subvencione dhe transfere 80,000€ dhe shpenzime kapitale 470,000 €. I kemi mbajtur diskutimet publike nëpër fshatra e Komunës së Hanit të Elezit. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo propozim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA BUXHETI I KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2022 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITIN 2023-2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Draft plani i punës së kuvendit të komunës për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- është krijuar një praktik e mirë të plani i punës së kuvendit të komunës që po hartohet me komision sepse çdo herë është duke u përsosur sa më mirë. Në ora dhjetë kemi pasur takim me komisionin për hartimin e planit të punës. Nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA DRAFT PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- për shkak të pandemisë nuk ka filluar ende viti shkollorë dhe nuk kemi mundur me bërë krahasime nga viti i kaluar në këtë vit. Përgatitjet janë bërë nga ana e kuadrit po ashtu edhe përgatitjet higjieno teknike janë bërë nëpër të gjitha shkollat.

Kryesuesi thekson:- me çfarë skenari pritet me filluar mësimi.

Teuta Shkreta thekson:- çfarë është folur për vaksinimin e nxënësve prej moshës mbi gjashtëmbëdhjetë vite dhe çfarë propozimi ka dhënë Ministria e Arsimit.

Sabedin Hasallari thekson:- a keni informacione se sa nxënës janë prekur nga kovid i në komunën tonë

Menduh Vlasi thekson:- nga gjitha takimet të cilat i kemi pasur Ministria e Arsimit i ka lënë në kompetencë të taskforcave komunale me marr vendim se me çfarë skenari me filluar. Për vaksinimin e nxënësve Ministria nuk na ka thënë asgjë. Sa i përket nxënësve të cilët janë prekur nga kovid i janë pesë apo gjashtë nxënës.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA MBI FILLIMIN E VITIT TË RI SHKOLLORË 2021/2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Kërkesa e z.Sherif Lusnjani për ndërrim destinim të pronës.

Kryesuesi thekson:- ashtu siç u dakorduar te rendi i punës që të hynë edhe kjo pikë, kërkoj që të votohet dhe për mbledhje të kuvendit të dërgohet edhe material, rezultati i votimit ishte njëzëri

U VOTUA KËRKESA E SHERIF LUSNJANI PËR NDËRRIM DESTINIM TË PRONËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Teuta Shkreta thekson:- lokalet të cilat janë te kufiri me pasur mundësi që me punuar edhe më gjatë duke pasur parasysh pikën kufitare.

Rufki Suma thekson:- nuk mund të ndërhyjmë në vendit të cilat janë marr nga Qeveria në kuadër të kovidit , ndërsa nëse bazomi në rregullore ju lejohet me punuar 24 orë.


Mehmet Ballazhi thekson:- ka shumë punëtorë të cilët shkojnë dhe punojnë në Maqedoni a ekziston mundësia me pasur një leje më të veçantë për ata punëtorë apo ndonjë lehtësim punë e testeve.

Rufki Suma thekson:- sa i përket kufirit nuk lëshojnë për shkak se është vendim , mirëpo në QKMF është përgatitur një vërtetim në gjuhën Angleze për testin rapid dhe rezultati është negativ dhe është pranuar nga pala Maqedone dhe brenda ditës afër 100 teste janë lëshuar për me kaluar kufirin dhe ndër kohë Drejtori i QKMF-së është konsultuar me nivelin qendrorë dhe ata i kanë sugjeruar se nuk keni të drejtë dhe janë ndërprerë.

Kryesuesi thekson:-a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 12:03

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava